

LENA MANDA

DAMKA

ROMAN

BOTIMET TOENA

LENA MANDA

DAMKA

Roman

Përktheu nga origjinali greqisht Albina Gjini Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: *Λένα Μαντά* (Lena Manda)
Titulli në origjinal: Η σφραγίδα
Botoi në greqisht: Psychogios Publications S.A.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktore letrare: Besa Vila
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817327

© 2022 by Psychogios Publications S.A.

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Pak fjalë prej meje...

Që t'ia filloj pikërisht aty ku e lashë, te *Fustani Jeshil*, ku shënimin hyrës e përfundoja me një urim: Kur të dilte në qarkullim të kishim shpëtuar nga... kovidi i mallkuar! Dëshira ime nuk u realizua. Dhe jo vetëm ai libër, por edhe ky që mbani në duar po gjatë pandemisë u shkrua!

Ideja më lindi një mbrëmje të ftohtë dhe të zymtë, teksa ndieja një mërzi, që pothuajse të gjithë e kemi provuar gjatë asaj periudhe. Oxhaku ishte i ndezur dhe unë me Jorgon kishim zënë nga një divan secili dhe, me dëshpërimin që na dallohej në sy, pasi kishim ngrënë çka kishim, pasi kishim lexuar sa s'mundeshim më, pasi kishim kërkuar në të gjitha platformat që të gjenim një serial të ri, ta ndiqnim për të hequr pak mendjen, rastisëm në një film dokumentar! Saktësisht "Makina e kohës", që na bëri përshtypje (punë e lavdërueshme e zotit Kristo Vasilopulo) dhe fillojmë t'i shohim episodet njërin pas tjetrit...

A e di se çfarë thonë? Se të gjitha aksidentet janë çështje sekondash. Edhe... lumturitë gjithashtu, them unë. Midis

gjithë atyre që pamë, ishte dhe tema e romanit tim. Nuk thashë gjë, por që në atë moment nuk pashë më asgjë tjetër. Në ekranin e televizorit pamjet lëviznin vazhdimisht, por mendja ime kishte hyrë në... binarë të tjerë. Të nesërmen e pashë përsëri atë video: institucion riedukimi për vajzat.

Fillova nga puna si gjithmonë, por (mos qeshni) hunda ime ndryshoi formë ngaqë shumë herë u ndesha me një mur. Informacionet e pakta për këtë temë, që të mos them inekzistente. Nga njëra anë krijoja personazhet e mia dhe nga ana tjetër kërkoja dhe s'gjeja gjë. Mos të të qëllojë një gjë e tillë! Ekzistonte edhe filmi i Delianidhit "Stefania", por nuk e pashë asnjëherë që të mos ngatërrohesh. Diku tjetër kisha ndër mend t'i ktheja dritat e penës sime (të tastierës që të jem më e saktë). Por e bleva librin. Po, ekziston libri i shkruar nga Neli Theodoru, ku u bazua filmi, dhe rastisa të blija një kopje të nënshkruar të vitit 1965! Gjithashtu, bleva edhe librin e zotit Jani Qerofilla "Athina në vitet '60" dhe nisa ta lexoj para se të ulesha për të shkruar.

Vërtet, sa udhëtime të bukura bën një shkrimtar para se të hedhë në letër fjalën e parë, para se t'i shëtisë lexuesit në shtigjet e mendjes së tij!

Në ndryshim nga *Fustani jeshil*, këtë herë mendja bashkëpunoi plotësisht. As boshllëqe, as mohime, as pushim! Fjalët, plot xhentilesë, fisnike, nuk kishe nevojë t'i kërkoje, por të ofroheshin vetë. Ndërkohë që gjithçka rreth meje po shembej si në anën figurative, por edhe në të vërtetë, nervat e mia tendoseshin në mënyrë të skajshme deri në atë pikë sa po shfaqeshin probleme psikomotorë, që nuk është vendi këtu t'i përmend. DAMKA ime... njolloste

dhe vazhdonte më tej. Zgjohesha që pa gdhirë (më mbeti si zakon që kur shkruaja *Udhëtim në Venecie*) dhe punoja deri në drekë. Dhe në këtë moment vjen përgjigjja e pyetjes së zakonshme të lexuesve dhe të gazetarëve: “Zonja Manda, kur shkruani një libër, e dini me saktësi se si do të zhvillohen ngjarjet?”. Po, e dija, nuk do të them gënjeshtër... Por nuk e shkrova! Përfundimi s’kishte asnjë lidhje me variantin fillestar. Gjatë udhëtimit të mrekullueshëm të këtij libri, të gjitha ndryshuan, madje edhe personazhet e mi. Asnjëri nuk përfundoi ashtu siç filloi. Sa joshës edhe ky fakt!

Gjithashtu, ashtu si në librin e mëparshëm, nuk m’u desh t’i kërkoj falje askujt që u zhduka dhe u mbylla në zyrën time. Të gjithë ishin mbyllur në shtëpitë e tyre! Tani që e mendoj, dikujt duhet t’i kërkoj falje... Burrit tim, që ia shkatërrova nervat, sepse për shkak të pandemisë dhe *lockdown*-eve të përsëritura (për karantinën e kam fjalën) rrinte në shtëpi, por duhet të lëvizte pa u ndier, të shihte televizor pa zë, pra i lejohej vetëm të merrte frymë... Siç e shihni, disavantazhi i shtëpisë sime është se ka shumë mjedise të përbashkëta. Në fund, pak para se të zhvendosej, solli një usta, ngriti një mur (të mos ndihem, përderisa nuk më muosi dhe mua) dhe më ofroi një zyrë krejtësisht të veçuar. U qetësuam që të dy.

Po jua dorëzoj, pra! Gjykimit tuaj dhe ndoshta dashurisë suaj! Shpresoj dhe uroj që sivjet t’ia dal të jem pranë jush, se më keni munguar tej mase!

Lena Manda

HYRJE

Gjithçka brenda meje thërriste me të madhe një “jo”, por buzët mbetën të shtrënguara. Isha shumë e vogël por kisha mësuar, që atëherë kur mbaja mend veten time, të njihja kotësinë e të kundërshtuarit, të rebelimit, të pretendimit. Asnjëri rreth meje nuk kishte të drejta, vetëm detyrime dhe një rrjedhë të pafundme “duhet”, që fërshëllenin kërcënueshëm në veshët e mi gjithmonë dhe gjithkund.

Dora po më dhembte nga pesha e valixhes që mbaja, por shpirti im dhembte më shumë teksa dhimbja kafshonte çdo skaj të tij. Doja t’ia merrja vrapit, megjithatë vazhdoja të ecja, e bindur, duke shkelur pothuajse aty ku shkelte ajo figurë e errët që më printe përpara. Nuk ishte kthyer as të më hidhte sytë, ishte i sigurt që e ndiqja pas...

Me dorën që kisha të lirë fshiva diçka të lëngshme që rridhte në faqe dhe vetëm atëherë kuptova që ishin lot. U përzien edhe ata me një rrëke gjaku që kishte rrëshqitur nga buzët e mia të çara. Me siguri unaza, që ai nuk e hiqte

kurrë, kishte shkaktuar plagën. Dija gjithashtu se dhe disa tufa të shkulura nga flokët e mi, u ngatërruan në gishtërinjtë e tij pak më parë.

Ecja me kokën ulur, i numëroja një e nga një hapat që po më çonin larg shtëpisë sime, larg sigurisë së saj: ai ishte i gatshëm të më ofronte si trofe gjahu te diçka kaq e tmerrshme saqë e bënte gjakun tim të ngrinte dhe frymëmarrjen time të rënduar, ndërsa mendja nuk mund të pranonte ato që po jetoja me të vërtetë gjatë atyre orëve të fundit. Diçka e hidhur më erdhi në grykë, dhunshëm, direkt nga stomaku i lodhur dhe ishte e pamundur ta mbaja, do të mbytesha. Lashë valixhen dhe u përkula e djersitur për të nxjerrë vrerin që ishte grumbulluar me tepri brenda meje. Me bisht të syrit e pashë të ndalonte, por pa u kthyer për të më parë, dhe në vazhdim të ecte përsëri, duke pritur që ta ndiqja pas. Besoj se në atë moment ra dhe mbiu menjëherë tek unë fara e parë e urrejtjes... Për herë të parë në vend të figurës së tij, dallova një përbindësh të frikshëm, të neveritshëm, pa gjurmë njerzillëku në asnjë qelizë të tij.

Ngrita valixhen dhe fillova të eci përsëri me gojën të mbushur me helm... jo vetëm... Helmi tashmë rridhte në damarët e mi. Ngrita sytë për pak, të shihja ku gjendeshim, duke u përpjekur të merrja me mend se sa do të ecnim akoma. Disa kalimtarë na shikonin, me vështrimin gjithë kureshtje. Nuk duhej të ishte normale pamja që kishin përpara. Ai trupdrejtë, me vështrimin e akullt që shihte drejt përpara dhe pas tij një vajzë e re, me flokë të shprishur, me fytyrën të gjakosur dhe të përlotur, duke ecur e përkulur me një valixhe të stërmadhe në duar. E ula kokën përsëri... Më vinte turp... Të paktën të mos shihja keqardhjen.

Dora m'u mpi nga pesha e asaj valixheje të mallkuar. Doja ta flakja, të hiqja qafe barrën e saj si dhe barrën që mbartte shpirti im, por e dija mirë se brenda asaj valixheje ngjyrë kafe ishte e gjithë pasuria ime. Rroba të ngrohta dhe çorape, një triko prej leshi që e kishte thurur ajo me kaq dashuri dhe unë u mburra kur e vesha për herë të parë, duke admiruar modelin me gërshetat simetrike, funde dhe një palë këpucë të reja që më kishte blerë për festa... Festat... Krishtlindja po afrohej, Lindja e Krishtit... As kjo nuk ishte në gjendje të zbuste zemrën inekzistente të përbindëshit që ecte para meje. Nga Lindja e Njeriut Perëndi zgjodhi të më çojë drejtpërdrejt te Kryqëzimi i Tij dhe kjo rrugë që s'kishte të sosur ishte Kalvari im. Ndoshta Jezusi, ashtu si unë, nuk do të dëshironte që të mbaronte ai itinerar, në fund të të cilit priste vdekja. E ngadaltë dhe torturuese ishte vdekja e Atij, ashtu siç dyshoja se do të ishte edhe e imja...

E kalova përsëri valixhen në dorën tjetër. Si mund ta flakja dhe të shpëtoja nga pesha e saj, kur ato që kishte brenda do të ishin dhe të vetmet gjëra të mia për... për sa kohë, vallë? Çfarë më priste në të ardhmen time të pasigurt dhe të zyrtë?

Një makinë më kaloi pranë dhe drejtuesi i saj, i bezdisur nga prania ime, i ra borisë me të gjithë forcën duke bërë që të hidhesha përpjetë e trembur. Në fund të fundit ndoshta kjo mund të ishte zgjidhja. Një çast guximi që të hidhesha te rrotat e një makine dhe atëherë të gjitha do të merrnin fund. Por nuk e kisha guximin... Mosha ime shtatëmbëdhjetëvjeçare rebelohej teksa mendoja vdekjen.

Nuk mund të ishte ky fundi... Edhe errësira më e thellë, diku zhduket...

Në mendje më erdhën pa i ftuar të gjitha ato çka ndodhën pak orë më parë, në shtëpinë që ndodhej në rrugën “Isavron”... Në shtëpinë ku u përballa për herë të parë me botën dhe u mësova me të duke bërë hapat e mi të parë. Dëgjova qartë vajtimin, por edhe përgjërimet e saj. Ishte ulur në gjunjë dhe lutej, por më kot siç rezultoi, pasi ai nuk tregoi mëshirë të zgjidhte një dënim tjetër. Ajo e kishte kapur nga gjunjët dhe ai e kishte shkëlmuar, ashtu siç shkëlmon një qen rrugësh, pa marrë parasysh se edhe ai ndien dhimbje... Kujtesa ime, ende e krisur nga tronditja e madhe, më tradhton, nuk e di a e goditi edhe atë, në tërbimin e tij për të rrafshuar gjithçka që ai kujtonte se duhej rrafshuar. Mua domethënë... Isha gjithmonë e tepërt në jetën e tij dhe e vetmja vlerë që njihje tek unë ishte se kurrë nuk i shkaktova as problemin më të vogël. E qetë, e disiplinuar, e bindur, pothuajse e padukshme. Vetëm një gjë të tillë mund të pranonte nga një grua të cilën e konsideronte të tepërt për të ekzistuar mbi tokë... Kjo ishte pikëpamja e tij për të gjitha gratë... Fakti që ekzistonte edhe një djalë në atë shtëpi e bënte të duronte edhe gruan e tij... Të vetmen gjë për të cilën e vlerësonte... I bëri një djalë... Pra, vlente diçka... Por mendimi i saj nuk merrej asnjëherë parasysh, zëri i saj duhej të dëgjohej sa më pak të ishte e mundur. Nuk kishte të drejtë ta shihte burrin-pronar të saj në sy.

Por, atë pasdite, gratë e kishin transformuar në egërsirë. Unë, me mëkatin e tradhtisë së lartë, dhe e shoqja, sepse kishte kundërshtuar vendimin e tij. Dhe mes të tjerave,

më erdhën në mendje dy sy dhe një vështrim; i huaj dhe i çuditshëm në atë furtunë që mbizotëronte. Sytë të ngulur tek unë dhe vështrimi në fillim i pëlqyeshëm, i kënaqur; një shkëndijë keqdashjeje xixëllonte pa pasur nevojë që të fshihej. Por vetëm kur u dëgjua dënimi vetullat u ngritën përplotë me çudi, habia e shkundi trupin dhe e detyroi të bënte disa centimetra mbrapa. Diçka po përpiquej të dilte në sipërfaqe nga ai kujtim, por mendimet, çdo konotacion i logjikshëm rrëshqiste si rërë midis gishtërinjve gjysmë të hapur. Koka më dhembte, kërcënonte se do të bëhej një mijë copash, por vazhdoja të ecja si robot, as peshën e valixhes nuk e ndieja më.

Ajo figurë si hije, që ecte përpara, më në fund u ndal. Ngrita kokën dhe e pashë të vështronte lart para një ndërtese. Ndoqa vështrimin e tij që të dalloja edhe unë shtëpinë time të re. Një e dridhur përshkoi gjithë trupin tim, dhe valixhja më rrëshqiti nga duart. Gjithandej kangjella dhe një mur i lartë e ndante botën e jashtme nga ferri, për ta bërë dallimin edhe më të theksuar. Jashtë murit qytetarët e virtytshëm. Brenda murit, mbeturinat. Një vendgroposje shpirtrash.

Lart, një tabelë ku shkruhej me germa kapitale: SHKOLLË RIEDUKIMI PËR VAJZAT. M'u kujtuan të gjitha ato që herë pas here ishin dëgjuar në shtëpinë tonë për këtë ndërtesë që strehonte fundërrina, sipas mendimit të këtij njeriu që më solli sot këtu, që të më dorëzonte pa iu skuqur faqja, te xhelatët. Dhe ky ishte vetë babai im. Për herë të parë e vështrova.

- Mos më lini këtu... - guxova të pëshpërit, por përgjigje nuk mora.

U mpiva përsëri nga dhimbja, teksa dora e tij më kapi nga flokët dhe më shtyu drejt hyrjes. Dhe këtë herë, që të mos humbiste kohë, e ngriti vetë valixhen që të kalonim një orë e më parë një prag, shkallët e pakta të të cilit përfundonin te vetë ferri. Mbi kokat tona, në hyrje, arrita të lexoj një pllakë mermeri:

GTATË QEVERISJES SË ELEFTHERIOS VENIZELLOSIT, ME MBRET ALEKSANDRIN, ME MINISTËR TË KUJDESIT SOCIAL SPIRIDHON SIMOM, ME DONATOR ZEMËRGJERË ANTON EMPIRIKON, TË BIRIN E ANDREAS, KËTU, NË KËTË FUSHË QË E DHUROI BASHKIA E ATHINËS NGRIHET GODINË-AZILI PËR FËMIJË TË PASTREHË DHE GURI I THEMELIT VENDOSËT NË VITIN SHPËTIMTAR 1917.

Kaq shumë emra të njohur dhe të famshëm u mbloodhën në një copë mermeri, sepse brezat e ardhshëm duhet të mësonin për ata që ndërtuan diçka ku të strehohej fatkeqësia... Vite më vonë, fatkeqësia ishte bërë plagë dhe e shkaktonte vetë ajo ndërtesë. Ata bamirës vizionarë, që e ideuan, do të vazhdonin më tej apo do të çrrënjosnin gurin e themelit vallë, nëse do të dinin të ardhmen e tij?

Dera u hap, një grua që ngjante më shumë me një burrë, fytyrëngrysur, veshur me një fustan ngjyrë kafe të errët, na hodhi një vështrim dhe pastaj bëri mënjanë që të hynim. Një errësirë e plotë më përpiu...

KAPITULLI I PARË

Rruga “Isavron”.

Dhe emri i saj... Frederika!
Pothuajse nuk u dëgjuan fare pëshpërimat pas komunikimit të emrit në pagëzimin e vajzës së Vasil dhe Luiza Renesit atë pasdite të ftohtë dimri të asaj të diele të vitit 1950. Të paktë dhe të ftuarit. Pesë vjet më parë, në pagëzimin e djalit, fëmijës së parë të familjes, shtëpia në rrugën “Isavron” ishte mbushur plot me njerëz dhe vera derdhej lumë, pavarësisht kohëve të vështira pas luftës dhe pushtimit fashist. Por Vasil Renesi ishte krenar për djalin... trashëgimtarin... Lindja e vajzës u duk se nuk i bëri përshtypje, madje mbeti pothuajse i pakënaqur. Vetë ai zgjodhi t’i vinte emrin e mbretëreshës, sepse brenda vetes, në këtë mënyrë, i jepte vlerë diçkaje që e quante të tepërt: një grua...

U kthyen në shtëpi me ata pak të ftuar për t'u ofruar të paktën një ëmbëlsirë e një liker dhe foshnja e sapopagëzuar flinte e qetë në krahët e së ëmës. Vogëlushja sikur ta ndiente që në praninë e babait të saj, duhej të tërhiqte sa më pak të ishte e mundur vëmendjen e tij dhe nuk qante asnjëherë, e as grindej. Njësoj si Luiza... Që nuk ndihej, ishte pothuajse e padukshme. Madje edhe shërbyesja, Arhondulla, që dallohej për zërin e saj kumbues, para të zotit të shtëpisë as që ndihej. Fiziku i saj i fortë sikur tkurrej, bëhej një grusht dhe kishte mësuar të ecte lehtë, pa u dëgjuar. Gjithë gratë e shtëpisë kishin për detyrë t'i shërbenin zotërisë, pa e bezdisur, dhe, kryesisht, pa bërë zë...

Asnjërin prej tyre nuk e kishte goditur ndonjëherë Vasili. Vetëm ndonjë të shtyrë u kishte dhënë, por mënyra e dhunshme dhe intensiteti i së shtyrës i kishin kushtuar herë pas here Luizës dy krisje në njërin dorë, një kaviļje të përdredhur dhe një vetull të çarë. E fundit ishte atëherë kur u kthye lehonë në shtëpi pas lindjes së Frederikës. Vasili as nuk e mori mundimin të shkonte ta merrte në maternitet, u kthye vetë me një taksì që ia gjeti një infermiere, e cila u tregua e gatshme për ta ndihmuar. Nuk i ishte ankuar se e dinte që do të ishte e kotë të shprehte hidhërimin e saj për sjelljen e tij. Por, në drekë, kur erdhi për të ngrënë, ishte ai që e provokoi duke i thënë:

- Merre shpejt veten, se dua të bëjmë fëmijë të dytë!

- Të tretë besoj se do të thuash, Vasili im... - guxoi t'i thoshte duke i mbushur gotën me ujë.

- E di se çfarë them! Kujton se e llogaris për fëmijë këtë vajzën që më lëshove këtu? - i bërtiti duke e shoqëruar

fjalinë me një grusht në tavolinë dhe duke përmbysur gotën e sapombushur me ujë.

- Por, sido që të jetë, fëmija yt është edhe vajza jonë...

- Grua, mos i jep shumë gojës! - iu vërsul ai. - Vajzat janë bela! Edhe pajë duan që t'i heqësh qafe, por edhe nderi yt rrezikon në çdo hap të tyre! Bota u përket burrave! Për çfarë duhet një grua?

- Për të lindur burra, Vasili im...

Nuk i pëlqeu fare përgjigjja e saj dhe kryesisht fakti se kishte gjetur kurajën për ta kundërshtuar. Brofi në këmbë duke sharë dhe e shtyu me kaq forcë sa që gruaja humbi ekuilibrin dhe koka iu përplas te dollapi që ndodhej mbrapa saj. As që u kthye për ta parë; iku duke mallkuar fatin e tij të keq që i vuri mbi shpinë një grua që nuk e linte të qetë.

- Një kafshatë bukë erdha të ha dhe ma nxore nga hundët! - ishin fjalët e tij të fundit para se të dëgjohej zhurma e derës që u mbyll pas tij.

Arhondulla erdhi menjëherë dhe u tremb kur pa zonjën që po përpiqej të ndalonte gjakun që rridhte nga vetulla dhe i rrëshqiste në faqe.

- E marrtë dreqi, mosmirënjohësin. Nga Zoti ta gjejë belanë! Nuk respektoi as faktin që je lehonë! - i tha me zë të lartë dhe nxitoi të merrte pak akull që t'ia vinte për të ndaluar hemorragjinë.

- Mos bërtit, Arhondulla, se na tremb foshnjën! Ku është Foti?

- Po luan në sallon, mos ki merak, zonja ime! Shih hallin tënd!

Me lëvizje të shkathëta u kujdes për plagën dhe e lidhi sa më mirë që mundej. Pastaj e uli dhe i bëri një kafe që të merrte veten.

- Mos lëviz, zonja ime... Rri e qetë që mos fillojë të të rrjedhë përsëri gjak dhe pastaj do të më duhet të të çoj në spital, - i tha teksa i përkëdhelte dorën me dhembshuri.

Asnjë pikë loti nuk rrodhi nga sytë e Luizës. Së bashku me shpirtin e saj, që ishte shkretuar, i ishin tharë dhe lotët. Edhe zemra i kishte ngrirë, dhe u varros atje në malet e Shqipërisë dhjetë vjet më parë...

E reja Luiza Raisi hodhi një vështrim vjedhurazi tek unaza e martesës që shkëlqente në njërin prej gishtërinjve të dorës së saj të majtë dhe për pak humbi nëpër ëndrrat që ishin kalitur së bashku me floririn e unazës së saj. I dukej sikur kishin kaluar vjet nga dita kur i ati, Kirillo, e kishte fejuar me Apostolin, por në të vërtetë kjo kishte ndodhur vetëm disa muaj më parë. Atë mbrëmje të ëmbël, në fillim të tetorit të vitit 1940, u hodhën themelet për jetën e tyre të bukur të përbashkët. Disa ditë më pas plasi lufta, Apostoli u nis për në front dhe ajo mbeti aty duke priturat letrat e tij. Në vend që ta shtrëngonte në krahët e tij, ai flinte dhe zgjohej duke mbajtur armën, rrethuar nga zjarri i betejës. Dhe ajo, në vend që të qëndiste pajën, thurte pa pushim së bashku me të ëmën triko dhe çorape për në Front. Në malet e Shqipërisë, edhe dëbora luftonte në krah të armikut dhe

mjekët përpiqeshin të shpëtonin jetë duke prerë gjymtyrë dhe duke shkatërruar ëndrra.

Një kollë e prerë dhe e thatë e largoi nga mendimet e saj. E ëma me vështrimin e saj i bënte shenjë që të ulte kokën e të vazhdonte të thurte. Nuk ishin kohë për ëndërrime. Arma e tyre ishin shtizat dhe me to luftonin me mijëra gra në prapavijë.

Luiza filloi përsëri të thurte e skuqur nga turpi. Çdo triko që përfundonte shpresonte se ndoshta binte në duart e tij, e ngrohte atë dhe i mbante plumbat larg tij. Netëve, kur shtrihej në krevatin e saj, para se të flinte, rilexonte letrat e tij, i kishte mësuar përmendësh dhe i kishte mbushur me puthje të panumërta. E ndiente se Apostoli përpiqej të mos ia përshkruante të gjitha, por vetëm ato që mund t'i duronte zemra e së dashurës së tij njëzetvjeçare, por ajo e njihte aq mirë sa mund të lexonte dhe midis rreshtave. E dashuronte si prej një jete, njihte çdo vështrim të tij, çdo tkurrje e fytyrës së tij të bukur për të ishte lehtësisht e lexueshme. Dhe sa më të lehta të ishin ato letra në përmbajtje, aq më shumë e kuptonte se atje lart gjërat po vështirësoheshin gjithnjë e më shumë. Kishte maktë kur flinte, brofte në këmbë e djersitur, kishte ftohtë, etje dhe uri. Ndihej ashtu siç ndihej ai.

Me lëvizje të shkathëta mbylli sythat e shpinores që po thurte dhe, pa u vonuar, filloi të shtonte sytha për mëngët. Duart i ishin mpirë dhe i fërkoi për pak duke vështuar të ëmën dhe zonjën Zoi, fqinjën që banonte te shtëpia përballë, që po thurnin çorape.

- Pse bëhen luftërat? - pyeti duke iu drejtuar të dyja grave.

- Që të shpenzojnë të paudhët plumbat që prodhojnë! - ia priti zonja Zoi dhe në çdo fjalë që nxirrte nga goja dukej sikur pështynte vetë Musolinin në fytyrë. - Dhe ata të paudhë antikrishtë ndërsejnë fëmijët e njerëzve të thjeshtë që të vriten!

Luiza u zbeh vetëm duke dëgjuar për vdekjen dhe gruaja zemërmirë nxitoi ta linte punën dhe të ulej pranë saj. Ia hodhi dorën supeve dhe e shtrëngoi për t'i dhënë kurajë.

- Nuk e thashë për Apostolin, bija ime! - nxitoi të justifikohet. - Po flisja në përgjithësi... Trimi yt po lufton si luan dhe do të kthehet fitimtar!

Vendin bosh pranë saj e zuri e ëma. Ia mori duart dhe ia shtrëngoi lehtë.

- Nuk duhet të të shkojë mendja për keq, Luiza... Apostoli po bën detyrën e tij ndaj atdheut dhe ne tonën. Prandaj thurim. Që të mos kenë ftohtë bijtë tanë nëpër male dhe të kthehen pranë nesh të shëndetshëm kur të mbarojë lufta.

- Por kur do të mbarojë, mama? Të gjithë thoshin se do t'i flakim në det italianët shumë shpejt! Por kanë kaluar muaj dhe lufta e mallkuar nuk po mbaron! Kaloj vjeshta, erdhi dimri, për pak do të hyjë pranvera dhe unë në verë do të martohesha... Ndërsa tani...

- Luiza! - E ëma u ngrit me një pamje të ashpër dhe me buzët të shtrënguara. - Një komb i tërë po lufton, gjithë bota po përpiqet të pengojë dy të çmendur që ta pushtojnë. Dhe ty e vetmja gjë që të intereson është martesë? Mendoja se të

kisha rritur ndryshe! Duhet të tregohesh më pak egocentrike, bija ime!

- Mua nga e gjithë bota vetëm Apostoli im më intereson!
- iu përgjigj me kokëfortësi vajza. - Këtë luftë nuk e donim as unë e as Apostoli! Sapo shkëmbyem unazat ma morën! Mezi prisja momentin të dilja krah tij dhe, pa u gëzuar mirë, u ndamë dhe më mbetën vetëm letrat dhe trikot që thur gjithë ditën!

- Luiza, eja në vete se përndryshe do të ta fus me shpulla, - i bërtiti e ëma e zemëruar.

Zonja Zoi gjykoi se ishte momenti për të ndërhyrë.

- Nuk është momenti të grindeni. Në vend që të thurim leshin, do t'i nxjerrim sytë njëra-tjetrës? - u kthye nga mikja e saj para se të vazhdonte: - Hë dhe ti, harrove se sa e padurueshme është rinia dhe sa egoiste ngjan dashuria! Dhe ti, vogëlushe, duhet të mendohesh pak para se të flasësh! Nuk po them, ke të drejtën tënde, por kush e donte luftën? Të tjerë na e sollën dhe e gjetshin belanë nga Zoti! Duro, bija ime! Apostoli do të kthehet dhe do të bëjmë dasmë të madhe! Sapo të kthehet trimi yt do të vishesh nuse!

Vetëm se Apostoli nuk u kthye kurrë... Në malet e Shqipërisë bashkë me të u varrosën edhe ëndrrat e Luizës. Si një pemë që e godet rrufeja e priti lajmin e vdekjes së tij, para se t'i binte të fikët para këmbëve të prindërve të saj, dhe kaluan muaj që ta merrte paksa veten. Nuk e kuptoi se si gjermanët hynë në Athinë, as pushtimin nazist nuk e mori vesh që në fillim. Çdo gjë rreth saj u shemb, prindërit e saj lëviznin si fantazma, fytyrështrenguar prej ankthit. Përpiqeshin të kursenin për të blerë gjërat më të

domosdoshme pa prekur monedhat e florinjta që kishin groposur nën dërrasat e bodrumit, ndërsa Luiza e ulur gjithë ditën në dhomën e saj, me fotografinë e Apostolit në duar, mërmëriste melodinë e valsit që kërcyen ditën e fejesës së tyre. Çdo burim jete kishte shterur brenda saj, vështrimi i saj i përhumur nuk fiksohej tek askush, thua se ishin të padukshëm. Fjalët e dashurisë që i pëshpëritnin së bijës as që arrinin ta preknin. I kaploi zhgënjimi dhe nuk dinin ç'të bënë tjetër dhe, megjithëse mjeku u thoshte të bënë durim, ata po treteshin së bashku me vajzën e tyre. Ditën e parë që e vështroni të ëmën dhe vështrimi nuk ishte më i zbrazët, e ëma filloi të qante dhe ra në gjunjë për të falënderuar Zotin që e bija u kthye prapë pranë tyre...

Por uria, vuajtjet, ankthi dhe pasiguria e thyen babanë e Luizës. Zemra e tij nuk duroi dhe do ta humbnin zotin Dhionis, nëse nuk do të ishte një doktor pensionist që do ta shpëtonte, me ato mjete të pakta që kishte Athina e pushtuar e asaj kohe. Nuk u bë kurrë si më parë, lodhej shpejt dhe rrallë dilte nga shtëpia, por të paktën ishte gjallë. Mjeku, pas ndërhyrjes shpëtimtare që i bëri, u bë pothuajse pjesëtar në shtëpinë e familjes Raisi. Ishte tip i këndshëm dhe mori përsipër një pjesë të madhe të barrës dhe të detyrimeve të mikut të tij të ri. Tashmë dilte ai për të kërkuar ushqime dhe ia dilte për bukuri. Dhe kur një ditë u kthye me dy grushte sheqer futur në bohçen e improvizuar me shaminë e vet, zonja Arsinoi zgurdulloi sytë.

- Sheqer? - thirri e habitur. - Ku e gjete? Shite shtëpinë?

- S'kemi arritur akoma deri aty! - iu përgjigj mjeku duke qeshur. - Uluni të dëgjoni si e pësuan gjermanucët!

U ulën të gjithë, madje edhe Luiza.

- Nga t'ia filloj! - tha me entuziazëm burri i moshuar. - Në fillim të periudhës së pushtimit kisha shëruar një djalë të ri që e kishte kapur plumbi shkarazi në një prej postblloqueve të gjermanëve. Që atëherë ky djalë, sa herë gjen ndonjë gjë të ngrënshme tepër të rrallë, më sjell edhe mua. Sot më priste poshtë shtëpisë sime me sheqerin. Kur u bombardua Pireu, u hodh në erë një anije dhe u shpërndanë gjithandej lira turke. Të papërdorshme, sigurisht, por gjermanët nuk e dinin. Shesin edhe ata çka vjedhin për të fituar diçka. Sigurisht, kur shkuan pastaj t'i shpenzonin për të pirë e për t'u dëfryer e morën vesh të vërtetën, por ishte vonë. Si dhe ku të denonconin për sheqerin e vjedhur?

Buzëqeshje kënaqësie u shpalosën në fytyrat e atyre që ndodheshin përballë tij, jo vetëm për atë dhuratë nga qielli, por kryesisht për faktin që pushtuesit ishin bërë rezil...

Pasditet i kalonin duke luajtur shah dhe tavllë, ndërsa gratë e shtëpisë, për aq kohë sa mund të shihnin me llambën e vajgurit, përpiqeshin të arnonin rroba dhe çorape. Një rrudhë e thellë ishte krijuar mes vetullave të zonjës Arsinoi. Me burrë të sëmurë dhe me një vajzë që ende përpiquej të merrte veten nga humbja e të fejuarit të saj, me gjermanët që çdo ditë e më shumë po shtrëngonin lakun rreth qafës së tyre, nuk shihte ndonjë mundësi se si do t'i ruanin të paprekura florinjët. Dhionisi e kishte detyruar t'i betohej që nuk do t'i prekte. Ishte e ardhmja e Luizës, sipas tij, por sipas logjikës së saj së pari duhej të sigurohej e tashmja. I shoqi nuk dilte më nga shtëpia që të shihte karrocën që transportonin të vdekurit, ose, edhe më keq, ata të vdekur

në gjendje të avancuar dekompozimi, sepse askush nuk i varroste. Sytë e saj ishin mbushur me tmerr, shpirti i rëndonte dhe netëve nuk e zinte gjumi; përpiqej të gjente një zgjidhje. Ishte fat i madh që ekzistonte doktori në jetën e tyre. Përveç historive që nuk mbaronin kurrë dhe që mbushnin netët e tyre, ndanin edhe pensionin e tij të papërfillshëm si edhe gjithçka tjetër që ai siguronte. Së fundmi, kuroi një gjerman që vuante nga ënjtja e kyçeve dhe ushqimet që siguronin ishin shtuar mjaft. Por kjo ishte zgjidhje provizore. E vetmja gjë që i jepte gëzim ishte fakti që e bija e kishte marrë veten plotësisht. Luiza sikur u zgjua ngadalë por në mënyrë të qëndrueshme nga një letargji e thellë. Merrte pjesë gjithnjë e më tepër në punët e shtëpisë derisa erdhi dita t'u bënte të ditur se do të kërkonte të gjente një punë të çfarëdoshme, gjë që e bëri të atin të ngrinte krye.

- U çmende? - e pyeti gjithë panik. - Ku do të shkosh të punosh kur jemi nën pushtim? Kush do të të punësojë dhe si do të të paguajë? Por edhe nëse gjen punë, mendon se do ta lejoj vajzën e vetme të Dhionis Raisit të punojë?

- Mos bërtisni, baba, dhe kryesisht mos u zemëroni, ju lutem! - iu përgjigj qetë Luiza. - Jeni njeri i arsyeshëm, duhet ta mirëkuptoni faktin se klasat shoqërore në gjendjen ku jemi sot nuk ekzistojnë më. Tani përparësi ka mbijetesa. Profesionit juaj si arkitekt është tashmë ëndërr e një nate vere, ndërsa mbijetesa jonë është nevojë imediate. Ushqimet, përveçse asaj që mezi gjenden, tashmë u bënë edhe të pakapshme për shkak të çmimeve. Çdo ditë rriten çmimet, racionet zvogëlohen dhe të gjithë përpiqen me

mish e me shpirt që të mbeten gjallë. Është luks i tepërt pra të flasim se kush dhe çfarë jemi.

- Ç'punë do të bësh, bijë? - ndërhyri e ëma.

Doktori u kollit dhe të gjithë e vështruan, duke ia dhënë fjalën. - Nëse më lejoni... - filloi të fliste me hezitim, duke parandier furtunën e kundërshtimeve që do të shpërthente pas pak, - kam një propozim, disi të tepruar ndoshta, por shpëtimtar ndoshta. Gruaja e gjermanit që po kuroj është paksa e shëndoshë. Qahet vazhdimisht se mezi i lyan thonjtë e këmbëve me manikyr...

E la fjalinë përgjysmë, teksa vetullat e Dhionisit ishin ngritur në mënyrë komike drejt rrënjëve të flokëve të tij, sytë i ishin rrumbullakosur ndërsa fytyra i ishte bërë flake e kuqe.

- Çfarë the, doktor? - iu vërsul i tërbuar nga zemërimi. - Ç'kujton ti se është vajza ime që të bëjë punën e pedikyristes te gratë e gjermanëve? Mos është ndonjë e rrugëve? Si munde ta nxjerrësh nga goja një gjë të tillë?

- Qetësohu, miku im, nuk e ofendova vajzën tënde, dhe as e kisha këtë qëllim. Besoj se është më mirë të bëjë këtë, sesa të punojë në ndonjë fabrikë të gjermanëve...

- Të lutem doktor! Luiza do të rrijë në shtëpinë e saj, si çdo vajzë që respekton familjen dhe emrin e mirë të saj!

- Baba! - u dëgjua të ngrinte zërin vajza - Mos ia vini fajin mjekut, propozimi i tij ishte i mrekullueshëm. Që kur puna është e pamoralshme? Nuk do të bashkëpunoj me gjermanët. Do të punoj dhe do të më paguajnë, ashtu siç bëjnë edhe me doktorin! Dhe nëse nuk do të ishte ai, e dini më mirë se kushdo, do të kishim prej kohësh probleme

mbijetese. Jam më e reja në këtë shtëpi, dhe unë do të punoj!
Dhe kur të vijë dita të shporren pushtuesit, do të bëhem
përsëri zonjusha Raisi, vajza e arkitektit! Por të shpëtojmë
nga kjo luftë njëherë!

- Nuk kuptoj si mund të dalësh për punë, - këmbënguli
babai. - Do të bësh durim, ashtu siç bëjmë të gjithë! Dhe kur
të mbarojë e gjithë kjo, rindërtimi medoemos që do të fillojë
përsëri, së bashku me profesionin tim. Dhe atëherë do të
mundesh edhe ti me pajën tënde të paprekur, të...

- Mos thuaj as edhe një fjalë, baba! Nëse kjo që doni
të thoni është se do të më gjeni një djalë të mirë që të
martohem, ju them se kjo nuk do të ndodhë kurrë! Përderisa
humba Apostolin, askush nuk do ta zërë vendin e tij! Kurrë!
Më dëgjuat? Kurrë!

Nga fjalët e saj u shtangën të gjithë. Luiza u mbyll në
dhomën e saj gjatë pjesës tjetër të ditës dhe e ëma, që rrinte
jashtë derës së mbyllur të dhomës së saj, e dëgjonte që qante
me ngashërime.

- Ç'mendove, miku im? - e pyeti mjeku Dhionisin kur
u ulën rreth tavolinës për të ngrënë një supë të shpifur. -
Se vajza jote ngaqë po i kthehet normalitetit e harroi djalin
që dashuronte? Plagë kaq të thella, që të çojnë në tronditje
nervore, nuk mbyllen lehtë dhe sot ti me fjalët e tua bëre që
plaga të kullonte prapë gjak.

- Ah, more Dhionis... - e mori fjalën gruaja e tij, - me
atë kokëfortësinë tënde! Si mund të përmendësh pajën dhe
martesën në momente të tilla? Në vend që të falënderojmë
Zotin që po përmirësohet...

... Nën atë presion të dyfishtë, ai u zbraps, teksa fjalët e së bijës i oshtinin në vesh. Po nëse ajo e kishte seriozisht dhe nuk martohej? Si do ta vazhdonte jetën në vetmi? Ç’do të bënte kur ata të mos jetonin më? Nuk e zuri gjumi dhe mendimet ishin kaq të shumta, sa koka e tij nuk ia nxinte më.

Luiza, pa e diskutuar më, i kërkoi doktorit ta prezantonte me zonjën që kërkonte pedikyriste dhe vuri të gjitha forcat që ajo të mbetej aq e kënaqur, sa t’ia sugjeronte edhe grave të tjera, gjë që ndodhi me të vërtetë. Tashmë kishte klientelë të zgjeruar dhe përveç të ardhurave që i shtoheshin buxhetit të tyre, ajo ripërtëriu edhe gardërobën e saj të konsumuar, pasi shumë prej atyre grave i jepnin edhe rroba që nuk u duheshin më. Por ndryshimi më i madh po ndodhte në botën e saj të brendshme. E ndiente se po qëndronte në këmbët e veta, gëzohej kur kthehej në shtëpi me para, por edhe me konserva dhe rroba, të cilat ishin pothuajse të reja dhe të një cilësie mjaft të mirë. E ëma ia përshtaste sipas trupit dhe kështu që me to Luiza vishej jo vetëm për vete, por ia jepte dhe vajzave të tjera të lagjes.

Vasil Renesi hyri në shtëpinë e tyre duke shoqëruar një bashkëpunëtor të vjetër të Dhionisit. Thanas Velopullo ishte sipërmarrës ndërtimi; para luftës ata të dy kishin punuar së bashku dhe ushqenin respekt të veçantë për njëri-tjetrin. Vinte herë pas here për ta takuar dhe bënin plane ambicioze për periudhën pas ikjes së pushtuesve. Atë ditë derën e hapi vetë Luiza dhe i ftoi të uleshin në dhomën e ndenjjes. E ëma me doktorin kishin ikur prej orësh pasi ishte hapur lajmi që në lagjen “Ampelokipos” dikush shiste lakra dhe vezë

dhe kjo e detyroi vajzën të merrte pozicionin e amvisës së shtëpisë. Nuk kishte shumë gjëra për të bërë. Në atë periudhë qerasja ishte e shumta një gotë ujë, të cilën ua ofroi mysafirëve para se të zhdukej në kuzhinë dhe prandaj nuk ia hodhi më sytë burrit të panjohur, i cili, për sa kohë që ajo ishte e pranishme, e vështronte me vëmendje.

- Që thua ti Dhionis, ky trimi këtu është djali i një mikut tim të vjetër. Erdhi para disa javësh nga fshati dhe i ati më porositi që ta mbaj afër. Ia kishin vënë syrin disa aty sipër dhe iku natën që të mos shkonte si qeni në vresht. Se çfarë hoqi derisa arriti në shtëpinë time, nuk tregohet! Vetëm netëve lëvizte, ndërsa ditën fshihej...

- Pse nuk u inkuadrua në njësitë e rezistencës? - pyeti me habi Dhionisi.

- Ata janë komunistë, zoti Raisi! - tha i shqetësuar Vasili për t'u përballur me vështrimin e ashpër të burrit përballë tij...

- Grekë janë! - e korrigjoi prerë Dhionisi. - Grekë që luftojnë për lirinë tonë. Nëse janë edhe komunistë, nuk e di dhe as që më intereson!

Një heshtje e rëndë mbizotëroi pas fjalëve të tij; Vasili u struk dhe nuk e hapi më gojën derisa ikën. Por dëgjonte me vëmendje gjithçka që diskutonin dy bashkëpunëtorët e vjetër dhe e kuptoi se i ati e kishte dërguar te njeriu i duhur. Thanasi dhe Dhionisi ishin mjeti për të arritur aty ku donte. Por bileta për të arritur tek ai mjet, ndoshta në atë moment ndodhej në kuzhinë...

Drugës së kthimit nuk e pati të vështirë të merrte vesh nga miku i babait të tij ato që i interesonin, teksa njeriu

zemërmirë i foli me entuziazëm për famën e Raisit dhe përfundimin tragjik të fejesës së vajzës së vetme të Dhionisit.

- Për pak sa nuk e humbën vajzën e tyre! - përfundoi me trishtim Thanasi. - Për muaj të tërë ishte në krevat dhe nuk fliste! Me zor e ushqenin që ta mbanin në jetë! Lëre se ç'hoqën, Vasil... Si të mos sëmurej nga zemra babai teksa shihte fëmijën të tretej nga dita në ditë? Por Lavdi Zotit tani e mori veten... e pe... Është për bukuri zog i vogël!

Mendja e Vasilit filloi të punonte. Një zog i plagosur është e lehtë të kapet në grackë.

Luiza mezi po hidhte këmbët në rrugën "Asklipiu" pasi pesha e dengut që mbante e kishte lodhur. Shtrëngonte dhëmbët, por, ishte e gëzuar për atë ngarkesë të çmuar. Dy pallto dhe një kostum ishin trofeu i asaj dite. Dy pallto burrash prej leshi, pothuajse të reja, por që mola ua kishte ngrënë jakat, dhe një kostum po i ngrënë paksa nga mola... Por me mjeshtërinë e zonjës Arsinoi në riparimin e rrobave, as babai i saj dhe as doktori nuk do të ndienin të ftohtin e dimrit që tashmë kishte filluar. Frau Liza, gjermania, ia kishte dhënë gjithë neveri dhe nuk e kuptonte për ç'arsye vajza e re, e cila kishte shfaqur talent të vërtetë në trajtimin e pjesëve fundore të gjymtyrëve të saj, ishte kaq e gëzuar për ca rroba të ngrëna mole.

Duke vënë të gjitha forcat, Luiza e shpejtoi hapin që të arrinte më në fund në shtëpinë e saj. Kishte frikë mos e sulmonin dhe ia merrnin gjërat që kishte me vete. Pushtimi i huaj, uria dhe skamja i kishin transformuar njerëzit në bisha. Instinkti i mbijetesës kishte lënë mënjanë çdo ndjenjë

fisnikërie dhe dhembshurie. Zëri që u dëgjua pranë saj e trembi dhe për pak u rrëzua.

- Mund t'ju ndihmoj, zonzushë?

U kthye gati për betejë, por u ndesh me dy sy të errët, por aspak kërcënues, që diçka i kujtonin. U ndal.

- Nuk më mbani mend! - i tha me një ton të këndshëm burri përballë saj. - Kjo do të thotë se nuk ju bëra aspak përshtypje kur më njohët...

- Kush jeni, zotëri? - e pyeti me një ton të prerë vajza.

- Vasil Renesi, zonzusha Raisi. Erdha para pak ditësh në shtëpinë tuaj, së bashku me zotin Velopullo... Ju erdhi ndër mend! - vazhdoi ai kur pa vështrimin e saj të ndriçohej...

- Tani që e dini se nuk do t'ju lëndoj, do më lejoni t'ju ndihmoj?

I dha dengun e madh dhe fërkoj duart e saj të lodhura.

- Të faleminderit.. - i tha thjesht dhe filloi të ecte duke e detyruar atë ta ndiqte pas.

- Të supozoj se po shkoni në shtëpinë tuaj? - vazhdoi ai.

- Po... Mbarova punën dhe po kthehem.

- Punoni? - Habia e tij dallohej qartë.

- Pse ju bën përshtypje? Kush mundet në ditët tona të bëjë ndonjë ditë pune, është me fat, apo jo?

- Po... sigurisht... por nuk prisja, që ju të kishit nevojë... dua të them dhe më falni, por vajza e një arkitekti me emër...

- Zoti Renesi, titujt nën pushtimin gjerman nuk të ofrojnë ushqim! Shihni të ndërtohet ndonjë gjë rreth nesh? Është periudha kur gjithçka shembet...

- Keni të drejtë, budallallëku im. E ç'punë bëni, nëse më lejohet?

- Kujdesem për thonjtë e zonjave, që të jenë të paraqitshme. Manikyr, pedikyr, - i shpjegoi kur vuri re habinë në vështrimin e tij. - Gratë e oficerëve paguajnë mirë! - vazhdoi ajo.

- Te gjermanët punoni? - pyeti ai, por në vështrimin e tij nuk dallohej qortim.

- Punoj, zoti Renesi! Nuk bashkëpunoj me ta! - e korrigjoi ajo.

- Nuk thashë gjë! - reagoi ai. - As patriotizmin tuaj nuk e cenova! Por, pyes veten, nëse tundoheni që gërshtëra, gabimisht të futet pak më thellë në gishtërinjtë e tyre!

Luiza i hodhi një vështrim dhe kur e kuptoi se çfarë i kishte thënë, nuk mund të mos buzëqeshte. Të njëjtën gjë bëri edhe ai.

- Duhet të buzëqeshni më shpesh, zonjushë! - komentoi ai duke u përpjekur që zëri i tij të dukej sa më i ëmbël. - Kështu si është katandisur bota, ka nevojë për buzëqeshje të ëmbla nga vajzat e bukura...

Papritur Luiza mori një pamje serioze dhe i hodhi një vështrim të rreptë. - Zoti Renesi, më duket se po i kaloni kufijtë!

- Një konstatim të thjeshtë bëra, zonja Raisi, nuk doja t'ju ofendoja.

Kishin arritur jashtë shtëpisë së saj dhe kishte ardhur momenti t'i jepte gjërat që po mbante.

- Ju faleminderit shumë, - i tha me sinqeritet. - Dhe më falni nëse pak më parë ju fola ashpër. Doni të vini lart?

- Më mirë të mos vij... Është drekë dhe vizitat në këtë orë janë të papërshtatshme. Por do të takohemi përsëri! - iu përgjigj dhe u largua me nxitim.

Luiza mbeti për pak duke e ndjekur me sy e menduar. Nuk ishte i bukur, madje njeri i zakonshëm, me flokë ngjyrë gështenjë dhe sy të errët; por i gjatë dhe truclidhur. Paraqitja e tij kishte diçka që Luiza nuk mund ta përcaktonte. Ngriti supet me indiferentizëm dhe hyri në shtëpi për t'i treguar së ëmës thesaret që kishte me vete.

As që e kuptoi se si hyri në përditshmërinë e saj Vasili. Gjithnjë i dilte përpara në rrugë me një justifikim. Herë të tjera e shoqëronte në shtëpi, herë të tjera shkëmbenin dy-tri fjalë nxitimthi, por kontakti ishte i përditshëm. Asnjëherë nuk kishte kërkuar diçka më tepër se takimet e shkurtra dhe në dukje të rastësishme. Kështu që propozimi i tij për të bërë një shëtitje, para se të hynte në shtëpi, e gjeti të papërgatitur dhe e habiti kaq shumë sa vonoi t'i përgjigjej dhe Vasili pati kohë të këmbëngulte.

- Ju lutem, zonzushë Raisi... Mos më kundërshtoni! Kam kaq kohë që ju shoqëroj për në shtëpi dhe e vetmja gjë që po kërkoj është të zgjasim pak rrugën që po bëjmë. Të bisedojmë pak më tepër... Qëkur kam ardhur nga Janina, i vetmi me të cilin shoqërohem është zoti Thanas. Është shumë i mirë, nuk diskutohet, por duhet ta pranoni se ju jeni shumë më e mirë për shoqëri! Kështu që mos më keqkuptoni që kërkoj të shoqërohem me ju...

Ai nuk kishte asnjë dyshim për rrjedhën që do të merrnin ngjarjet, që nga momenti kur e pa të buzëqeshte me fjalët e tij të fundit. Tani gjithçka ishte në dorën e tij.

- Domethënë jeni nga Janina... - tha Luiza, teksa vazhdoi të ecte në vend që të nxirrte çelësat e shtëpisë nga çanta, duke i dhënë të kuptonte që kërkesa e tij ishte pranuar.

- Po... Domethënë fshati im ndodhet pak jashtë qytetit të Janinës... - iu përgjigj ai duke futur duart në xhepin e palltos.

Çdo lëvizje e tij duhej të ishte e kujdesshme. Mbante një distancë sigurie prej saj, që në asnjë mënyrë të mos interpretohej se kërkonte diçka më tepër sesa shoqëria e saj për një shëtitje.

- E pse erdhët në Athinë dhe veçanërisht tani? Besoj se rrezikuat shumë deri sa të arrinit...

- Shumë, por këmbëngulën njerëzit e mi... Mua nuk më interesonte dhe aq jeta ime...

Ndezi një cigare dhe u përpoq të dukej sikur po i dridheshin lehtas duart. Ashtu siç u kujdes që tymi i cigares t'i hynte në sy sa t'i dilnin lot. Luiza u ndal dhe e vështroi e habitur.

- Të më falni nëse ju vura në pozitë të vështirë... Nuk ishte ky qëllim im, zoti Renesi! - i tha krejt e pavendosur.

- Nuk ka problem. Por janë të freskëta ngjarjet dhe dhimbja ende e madhe... Që ta dini, pata një histori të pafat me një vajzë... - Interesi që u rishfaq në vështrimin e saj i dha shansin të vazhdonte me sytë të ulur përdhe: - E dashuroja jashtë mase... Që fëmijë mund të them... Por dikush ishte xheloz për këtë dashuri... dhe bëri ç'ishte e mundur të më eliminonte... Në fund i gjithë fshati besoi se isha bashkëpunëtor i gjermanëve! Janë kaq të vështira kohët që po jetojmë. Njerëzit kërkojnë të shpërthejnë diku me gjithë ato që po heqin. Luftëtarët e rezistencës, partizanët, filluan të më kërkojnë kudo dhe u detyrova të fshihem.

Ajo më dashuronte dhe e dinte se kurrë nuk do të tradhtoja atdheun për të cilin kisha luftuar!

Ai u ndal për pak duke thithur thellë cigaren. Vështrimi i Luizës ishte i trishtuar, e vështronte me interes dhe dhembshuri, e inkurajoi të vazhdonte.

- Një pasdite kishim lënë takim me Sofinë para një kishëze... Nuk e di nga e morën vesh partizanët apo nëse ishte rastësi që na gjetën aty...

- O Perëndi! - ia bëri Luiza e shqetësuar. - Dhe çfarë ndodhi?

Ishte momenti kulmor për të dhe nuk duhej të dështonte. I ktheu shpinën, supet po i shkundeshin, pas tij ishte një pemë dhe ai u mbështet aty duke e fshehur fytyrën brenda duarve, para se të përgjigjej me zë të këputur: - Ma vranë... Filluan të qëllonin në drejtimin tonë dhe Sofia doli para meje që të më shpëtonte...

Luiza lëshoi një ulërimë, ndërsa sytë e saj u mbushën me lot. Instinktivisht dora e saj u ngrit dhe i shtrëngoi krahun, në përpjekje për t'i treguar mbështetjen e saj.

- Zoti Renesi... Vasil, bëhu i fortë... - i tha duke lënë mënjanë formalitetet. - Të dashuronte dhe besonte se ia vlente të vdiste për ty...

- Më mirë të kisha vdekur unë... - pëshpëriti ai dhe fshiu lotët, duke drejtuar trupin. E vështroi i trishtuar. - Më fal... Nuk kisha ndër mend të të thosha gjëra të tilla kur të ftova për një shëtitje... Ta nxiva ditën...

- Mos ki merak, Vasil. As ditët e mia dhe as shpirti im nuk shohin më dritë. Kjo luftë ka aq shumë dëme anësore...